



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo
Komuna Rahovec - Opštine Orahovac

Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë - Sektori për pronë
Odeljenje za Katastar, Geodeziju i Imovinu - Sektor za imovinu

Data - Datum	08.04.2019
Referencë/a	08 nr. 19/2019
Për/Za/To :	Kasim Tahir Bekeri nga Rahoveci
Zona Kadastrale:	Rahovec
CC:	
Përmes/ Prekp/Through:	Afrim Oruqi - Drejtor Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi, dhe Pronë
Nga/Od/From/	Sektori për pronë
Subjekt/Subekat/Subject:	Vendim

Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë - Sektori për pronë K.K. Rahovec duke vendosur sipas detyrës zyrtare, më datë 08.04.2019 në çështjen administrative uzurpim arbitrar të tokës në pronësi shtetërore të kryer nga ana e Kasim Tahir Bekeri nga Rahoveci, në bazë të nenit 16, 17 dhe 18 të Ligjit Mbi Shqyrtimin e Marrëdhënieve Pasurore të krijuar me uzurpim arbitrar të tokës në pronësinë shtetërore (" Gazeta zyrtare e KASK ", nr. 46/77 dhe 37/88), dhe nenit 21 të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 05/L-031, merr:

V E N D I M

I. VERTETOHET Se Kasim Tahir Bekeri nga Rahoveci me mbjelljen e vreshtit në pjesën e parcele shtetërore nr. **3818-0**, duke bërë zgjerimin e parcelës se vet nr. **3820-0** në dëm të parcelës shtetërore nr. **3818-0** siç është cekur më afër në skicën e terrenit të hartuar nga gjeodeti i kësaj drejtorie, në të cilën shihet pjesa uzurpuar e parcelës nr. **3818-0** sipas kulturës kullosë klasa 5, në sipërfaqe prej **804 m²** Z.K. Rahovec, në emër të P.sh. Kosov. K.K. Rahovec.

II. Uzurpuesi arbitrar Kasim Tahir Bekeri nga Rahoveci, është i obliguar që pjesën e parcelës së uzurpuara ta liroj, dhe të njëjtën ta kthej në gjendjen e mëparshme, në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë të këtij vendim.

III. Nëse i përmenduri në afatin e caktuar ligjor nuk e liron sipërfaqen e uzurpuar, vendimi do të ekzekutohet në mënyrë të dhunshme.

IV. Shpenzimet e procedurës bien në barrë të uzurpuesit arbitrar.

V. Uzurpimi është kryer në vitet e pas luftës në Kosovë.

A r s y e t i m

Drejtoria për kadastrë, gjeodezi dhe pronë – sektori për pronë i K.K. Rahovec duke vendosur sipas detyrës zyrtare në çështjen administrative uzurpim arbitrar ku zyrtarët së bashku me gjeodetën e kësaj drejtorie ka dal në vendin e ngjarjes dhe pas matjes dhe incizimit të pjesës së parcelës nr. **3818-0** ka konstatuar se i përmenduri me mbjelljen e vreshtit ka zgjeruar parcelën e vet nr. **3820-0** në dëme të parcelës shtetërore nr. **3818-0**, duke bërë uzurpim në sip. prej **804 m²**.

Pas vërtetimit të gjendjes faktike në vendin e ngjarjes eksperti teknik – gjeometri ka kryer matjen dhe kufizimin e ngastrave në fjalë, përkatësisht ka vendosur dhe shënuar kufijtë dhe ka hartuar skicën e terrenit, në të cilën është pasqyruar qartë pozita, kufiri dhe sipërfaqja e uzurpuar.

Gjatë evidentimit dhe shikimit në vend, personi zyrtar ka tentuar ta thërret personin në fjalë mirëpo ai nuk është paraqitur në vendin e ngjarjes që të merret në pyetje. Më datë 04.04.2019 i është bërë ftesë që të vijë në zyrën e kësaj drejtorie dhe me datë 08.04.2019 është paraqitur në zyrën e kësaj drejtorie në të cilën ka deklaruar se qëllimisht nuk ka bërë kurrfarë uzurpimi, por se nuk e ka ditur vijën kufitare të parcelës së vetë, dhe ka cekur se, do ti heqë hardhitë e mbjellura dhe shtyllat e betonit nga kjo pjesë e uzurpuar e kësaj parcele.

Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe administrimit të provave, në bazë të nenit 16, 17 dhe 18 të Ligjit mbi shqyrtim e marrëdhënieve pasurore të krijuar me uzurpim të tokës në pronësi shtetërore (“ Gazeta Zyrtare e KASK ”, 46/77 dhe 37/88), është vërtetuar se i përmenduri ka bërë uzurpim arbitrar në parcelën komunale, të cekur në dispozitë të këtij vendimi.

U vendos pranë Drejtorisë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë – Sektori i pronës K.K. Rahovec,
më 08.04.2019

08 nr. 19/2019

KESHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi mund të parashtrohet ankesë në Agjencinë Kadastra të Kosovës, Prishtinë, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimet nëpërmjet kësaj drejtorie.

Hartuesi

Jur. i Diplomuar. Nazmi Krasniqi



Drejtori

Jur. Diplomuar. Afrim Oruqi

